

RAPORTI VJETOR
ANNUAL REPORT **2013**



1

SIGAL UNIQA
KOMPANIA
LIDER
E SIGURIMEVE

46,692,100 Euro Prime

759,761 Kontrata

1162 Punonjës dhe Agjentë

26 Milion Euro Kapitali



UNIQA Insurance Group
Vlerësuar me “A” nga Standard & Poor’s

5.7 Miliardë Euro Prime

18.6 Milion Kontrata

22 000 Punonjës dhe Agjentë

2,790 Milion Euro Kapitali



CONTENTS PËRMBLEDHJE

01

SIGAL BUSINESS
CENTER



02

10 years of
partnership with
the American Fund



03

New Head
Offices in
Pristine



04

10 years of
SIGAL UNIQA
KOSOVA



05


Financial Analysis
and regional
meetings



Shtirirje rajonale	5
Fjala përshëndetëse	6
- Z. Andreas Brandstetter, CEO i UNIQA Insurance Group	
- Z. Avni Ponari, CEO i SIGAL UNIQA Group AUSTRIA	
Vlerat dhe parimet	11
Investitorë të huaj	11
Ngjarje të rëndësishme	12
- 10 vjet bashkëpunim me Fondin Amerikan	
- 10 vjet SIGAL UNIQA Kosova	
- Inaugurimi i zyrave të reja në Prishtinë	
- UNIQA Shkup rritje të qëndrueshme gjatë 2013	
- Të gjitha shërbimet e SIGAL UNIQA tashmë në një godinë të vetme	
- Takime dhe analiza financiare	
Përgjegjësia jonë sociale	17
Ne jemi SIGAL UNIQA	19
Shërbime lehtësuese për klientët	20
Të dhëna financiare 2013	23
Zhvillimet në tregun rajonal të sigurimeve	24
Raporti i auditit të pavarur	28
.....	
Regional Insurance Group	5
Forewords	42
- Mr. Andreas Brandstetter, CEO of UNIQA Insurance Group	
- Mr. Avni Ponari, CEO of SIGAL UNIQA Group AUSTRIA	
Our values and principles	47
Our shareholders	47
Important events	48
- 10 years of partnership with the American Fund	
- 10 years of SIGAL UNIQA Kosova	
- Inauguration new headoffice in Pristine	
- UNIQA Skopje: steady growth in 2013	
- SIGAL UNIQA services now offered in a single building	
- Financial analysis and workshops	
Our social responsibility	53
We are SIGAL UNIQA	55
Facilities for our clients	56
2013 Financial data	59
Regional insurance market development	60
Independent Auditor's report	29

REGIONAL INSURANCE GROUP

GRUP RAJONAL SIGURIMESH



Volumi i primeve (euro)

Premium volum

Group 46,692,100

AL 24,499,486

KS 11,151,600

MK 11,041,014

Nr. i kontratave

No. of contracts

Group 759,761

AL 259,682

KS 160,134

MK 339,945

Nr. i zyrave

No. of offices

Group 206

AL 108

KS 58

MK 40

Agjentë dhe punonjës

Agents and employees

Group 1162

AL 622

KS 170

MK 370

*Të dashur zonja
dhe zotërinj,
të dashur klientë,
të dashur partnerë
biznesi,*

Në vitin 2013 ne ndërmorëm një tjetër hap të rrugëtimit të gjatë që kemi filluar në kuadër të strategjisë sonë të re, UNIQA 2.0 aplikimi i së cilës ka filluar në mesin e vitit 2011. Ne u rritëm si kompani, reduktuam raportin e dëmeve, raportin e kombinuar dhe, mbi të gjitha, arritëm fitimin e synuar.

Një prej qëllimeve tona kryesore është rritja e numrit të klientëve në 15 milion klientë deri më 2020-ën (2013: 9.3 milion klientë) dhe synojmë ta arrijmë këtë duke u përqendruar në tregjet e sigurimeve në Austri dhe vendet e tjera të Europës Qendrore-Lindore ku jemi aktualisht prezent përmes 40 kompanive.

Përgjatë vitit 2013 grupi UNIQA Insurance Group arriti një volum primesh të shkruara prej 5.7 Miliardë Euro e cila shënon një rritje prej 6.2% në krahasim me një vit më parë.



Andreas Brandstetter
CEO, UNIQA Insurance Group
Kryetar, Bordi Mbikëqyrës i SIGAL UNIQA

Rezultatet pozitive që arritëm gjatë 2013-ës janë një motiv për të vijuar rrugën tonë drejt synimeve ambicioze që i kemi vendosur vetes dhe nuk përbën arsye që të kënaqemi me kaq.

Ne synojmë një rritje të qëndrueshme në sajë të zbatimit sistematik të projekteve dhe programeve tona të zhvillimit me fokus tek vendet e Europës Jug-Lindore si Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia. Jam i sigurt se tregu i sigurimeve në këto tre shtete dhe vendet e tjera të rajonit do të konsolidohet përgjatë

Përgjatë vitit 2013 grupi UNIQA Insurance Group arriti një volum primesh të shkruara prej 5.7 Miliardë Euro e cila shënon një rritje prej 6.2% në krahasim me një vit më parë. Rezultatet pozitive që arritëm gjatë 2013-ës janë një motiv për të vijuar rrugën tonë drejt synimeve ambicioze që i kemi vendosur vetes.

viteve në vijim dhe unë jam shumë i kënaqur që ne kemi njerëz kaq profesionistë në këto vende të cilët i njohin shumë mirë problematikat e tregut lokal dhe punojnë fort për të kontribuar në zgjidhjen e tyre.

Performanca shumë e mirë e grupit SIGAL UNIQA është një konfirmim i vendimin të duhur që morëm 7 vjet më parë për të bashkëpunuar me SIGAL si dhe thekson rëndësinë e besimit reciprok si baza e çdo marrëdhënie të suksesshme financiare.

Grupi SIGAL UNIQA (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni) është absolutisht një shembull i shkëlqyer i një menaxhimi të suksesshëm të kryesuar nga një largpamës dhe vizionar si CEO ynë Avni Ponari.

Me bindjen tek forcimi i këtij bashkëpunimi në të ardhmen, falënderoj stafin, klientët, partnerët dhe bashkëpunëtorët për përkushtimin dhe besimin e tyre.

Andreas Brandstetter

CEO, UNIQA Insurance Group

Kryetar i Bordit Mbikëqyrës, SIGAL UNIQA Group AUSTRIA

Qershor, 2014

Të dashur klientë, miq e bashkëpunëtorë të SIGAL UNIQA Group AUSTRIA

Kam kënaqësinë tju ftoj të ndajmë së bashku sukseset e rrugëtimit tonë të përbashkët gjatë vitit 2013 i cili solli sërish rezultate pozitive për të gjitha kompanitë SIGAL UNIQA në rajon.

Në sajë të strategjisë efektive që zbatuam, kapërcyem me sukses sfidat e tregut dhe të ekonomisë rajonale. Në krahasim me një vit më parë, u rritëm me 17% duke arritur kështu një volum primesh prej rreth 47 Milionë Euro në të tre tregjet ku operojmë. Të gjitha kompanitë SIGAL UNIQA patën një performancë pozitive përfshirë këtu edhe kompanitë e reja të themeluara vetëm dy vjet më parë, përkatësisht: Fondi i Pensioneve Private në Shqipëri dhe dy kompanitë e sigurimit të jetës në Kosovë dhe Maqedoni. Ndonëse të reja në treg këto kompani patën rritje dy-shifrore veçanërisht në Shqipëri dhe Kosovë duke dëshmuar kështu suksesin e produkteve novatore të prezantuara në tregjet përkatëse.

Rezultatet e mira financiare janë reflektuar



Avni Ponari
CEO, SIGAL UNIQA Group AUSTRIA
Anëtar, Bordi Mbikëqyrës i SIGAL UNIQA

rrjedhimisht edhe në pozicionin tonë në treg në të cilin, që prej vitit 2003, jemi në vend të parë me mesatarisht 32% të tregut.

Viti 2013 shënoi edhe dekadën e parë të bashkëpunimit të suksesshëm me Fondin Amerikan i cili është aksioneri i parë i huaj që hyri në tregun shqiptar të sigurimeve. Falë mbështetjes së tij SIGAL u shndërrua nga një kompani lokale në grupin më të madh rajonal të sigurimeve të përbërë nga 8 kompani. Performanca shumë e mirë financiare dhe suporti i Fondit Amerikan mundësuan hyrjen

Shifrat pozitive që kemi arritur janë provë e bashkëpunimeve të suksesshme që kemi përforcuar përgjatë këtij viti me aksionerët dhe partnerët tanë si dhe rezultat i përkushtimit maksimal të mbi 1000 punonjësve dhe agjentëve.

e një tjetër investitori strategjik në fushën e sigurimeve në vitin 2007 përmes bashkëpunimit me UNIQA Insurance Group. Në festimin e këtij partneriteti jam veçanërisht i lumtur teksa shoh se përkushtimi dypalësh dhe puna e palodhur ka shndërruar këtë investim në një histori të vërtetë suksesi si një ogur i mirë për arritjet në të ardhmen.

Këtë vit festuam edhe një tjetër përvjetor të rëndësishëm, vitin e dhjetë të aktivitetit në Kosovë. Në historinë e saj 10-vjeçare SIGAL UNIQA Kosova ka shënuar arritje të rëndësishëm dhe ka pasur ritme të shpejta zhvillimi duke u renditur ndër dy kompanitë më të mëdha në tregun kosovar ku operojnë 10 kompani sigurimi. Në 2011 investuam sërish në Kosovë duke krijuar SIGAL Life UNIQA Group AUSTRIA për sigurimet e jetës.

Gjatë 2013-ës kapitalizuam gjithashtu të ardhurat dhe punën tonë duke investuar disa milionë euro në shtimin e aseteve përmes zyrave të reja në Kosovë dhe zgjerimin e zyrave

qendrore në Tiranë duke synuar rritjen e cilësisë së shërbimit.

Shifrat pozitive që kemi arritur janë provë e bashkëpunimeve të suksesshme që kemi përforcuar përgjatë këtij viti me aksionerët dhe partnerët tanë si dhe rezultat i përkushtimit maksimal të mbi 1000 punonjësve dhe agjentëve.

Por mbi të gjitha këto rezultate janë certifikim i besimit në rritje i 1 milionë klientëve tek emri SIGAL UNIQA si kompania më e besuar e sigurimeve.

I bindur se suksesi iu përket atyre që guxojnë, ju ftoj të jemi sërish sëbashku në vitin e 15 të SIGAL UNIQA Group AUSTRIA duke synuar një të ardhme edhe më të sigurt.

Avni Ponari

CEO, SIGAL UNIQA Group AUSTRIA

Anëtar i Bordit Mbikëqyrës, SIGAL UNIQA Group AUSTRIA

Qershor, 2014

Një ndër qendrat
më të njohura të
biznesit tashmë
nën emrin
SIGAL Business
Center



Vlerat dhe parimet tona

Cilësia

Ofrimi i një shërbimi cilësor që të përmbushë nevojat e klientëve është fjala kyçe e aktivitetit tonë. Jemi Kompania më e madhe dhe më e besueshme e sigurimeve për shqiptarët të cilët kanë vlerësuar maksimalisht cilësinë e shërbimit.

Respekti

Respekti për nevojat, mirëqenien dhe opinionin e klientëve, punonjësve dhe partnerëve tanë janë në qendër të vendimeve që marrim çdo ditë. Ne tregojmë respekt në çdo hap që hedhim duke fi lluar nga dizenjimi i produkteve, strukturave dhe proceseve.

Mirësjellja

Ne besojmë se komunikimi është çelësi i suksesit për çdo kompani ndaj sjellja profesionale dhe korrekte si brenda Kompanisë ashtu edhe me partnerët dhe klientët është shumë e rëndësishme për ne. Ne i mbajmë dhe i zhvillojmë marrëdhëniet mbi bazën e besimit ndaj fokusohemi në gjetjen e zgjidhjeve të përshtatshme.

Harmonia

Ne i kushtojmë shumë rëndësi bashkëveprimit mes të gjithë aktorëve në punën tonë: klientëve, autoriteteve mbikëqyrësve, aksionerëve dhe stafi t. Organizimi që kemi është në funksion të një komunikimi të mirë së brendshmi dhe njëkohësisht në përputhje me kërkesat dhe dinamizmin e një tregu që zhvillohet dita-ditës.

Zhdërvjelltësia

Në punën tonë të përditshme nxitemi nga dëshira për tu ofruar vlera klientëve tanë dhe një mjedis pune të kënaqshëm për stafin tonë. Bazuar në këtë, jemi vazhdimisht të vëmendshëm ndaj opinionit dhe nevojave të tyre duke përshtatur shërbimin tonë.

Aksionerët tanë



UNIQA

UNIQA INSURANCE GROUP

UNIQA Insurance Group është aksioneri më i madh i SIGAL UNIQA. UNIQA është aksioner i SIGAL UNIQA që nga muaji Mars i vitit 2007 dhe zotëron 68.64% të aksioneve. UNIQA Insurance Group është një nga grupet më të fuqishme financiare në Europën Qëndrore dhe Lindore, nën emrin e së cilës përfshihen 40 kompani sigurimi që operojnë në 20 shtete. E vlerësuar në vijimësi nga 'Standard&Poor's' me "A", UNIQA është një gjigand europian sigurimesh.



Fondi Amerikan

Fondi Amerikan zotëron 13.3% të aksioneve të SIGAL dhe është aksioner i kompanisë që nga Tetori i vitit 2003.

Fondi Amerikan është themeluar me iniciativë dhe vendim të Kongresit Amerikan në vitin 1995 në kuadër të marrëveshjes "Për Demokracitë e Europës Lindore". Qëllimi kryesor i Fondit është të promovojë zhvillimin e ekonomisë në këto vende.

Investitorë vendas

18.06% e aksioneve të SIGAL UNIQA i përkasin investitorëve shqiptarë, njëkohësisht themelues të Kompanisë.

NGJARJE TË RËNDËSISHME

Fondi Amerikan dhe SIGAL UNIQA: 10 vjet bashkëpunim i suksesshëm

Fondi Amerikan është investitori i parë i huaj që hyri në tregun shqiptar të sigurimeve përmes blerjes së 13.3% të aksioneve të SIGAL sh.a. Hyrja e Fondit Amerikan dha një shtytje zhvillimit të tregut shqiptar të sigurimeve të sapo liberalizuar si dhe krijoi më shumë besim tek klientët dhe më shumë garanci tek investorët vendas e të huaj. Duke qenë një institucion i rëndësishëm financiar i fokusuar në investimet në fushat strategjike të zhvillimit, Fondi i mundësoi që në fillim SIGAL dhe tregut një mbështetje të fortë financiare dhe manaxheriale.

Falë mbështetjes së Fondit Amerikan, SIGAL u shndërrua nga një kompani lokale në grupin më të madh rajonal të sigurimeve të përbërë nga 8 kompani. Performanca shumë e mirë financiare dhe suporti i FSHAN mundësuan hyrjen e një tjetër investitori strategjik në fushën e sigurimeve në vitin 2007 përmes bashkëpunimit me UNIQA Insurance Group i cili është aktualisht aksioneri më i madh i SIGAL UNIQA.

Me rastin e 10-vjetorit të kësaj marrëveshjeje, Bordi i Fondit i kryesuar nga Z. Michael Granoff, Kryetar i Fondit, zhvilloi një takim dhe konferencë për shtyp në zyrat e SIGAL UNIQA. Në fjalën e tij, z. Granoff, ndër të tjera, u shpreh: “Ne jemi krenarë që jemi pjesë e kësaj kompanie dhe e këtij partneriteti. Ky investim i yni është një histori suksesi pasi ne kemi hyrë në tregun e sigurimeve për ta ndryshuar atë dhe në 10 vjet SIGAL e ka arritur. Së bashku me SIGAL kemi dhënë kontributin për të zhvilluar sektorin e sigurimeve. Jemi të bindur se së shpejti SIGAL do të jetë një kompani udhëheqëse edhe në rajon kjo sepse tregu i sigurimeve është një treg me potencial të jashtëzakonshëm.”

Duke falënderuar Fondin për besimin, bashkëpunimin dhe mbështetjen përgjatë viteve, Drejtori i



Z. Michael Granoff, Kryetar i Fondit Amerikan dhe Z. Avni Ponari, CEO i SIGAL UNIQA në 10-vjetorin e bashkëpunimit me Fondin Amerikan.

Përgjithshëm i SIGAL UNIQA Avni Ponari theksoi “10 vjet mund të duken pak por në fakt ka qenë një periudhë e mbushur me shumë sfida dhe arritje për ne. Përgjatë kësaj periudhe SIGAL ka 10-fishuar kapitalin, 6-fishuar volumin e primeve dhe është shndërruar në një grup të madh rajonal sigurimesh. Në këtë përvjetor jemi krenarë sepse kemi ruajtur për 10 vjet të njëjtën pjesë të tregut prej 30 % pavarësisht se kur hyri Fondi ishin vetëm 5 kompani dhe sot përsëri kemi po të njëjtën pjesë të tregut ndonëse sot operojnë 12 kompani sigurimesh.”

Fondi Amerikan është themeluar me iniciativë dhe vendim të Kongresit Amerikan në vitin 1995 në kuadër të marrëveshjes “Për Demokracitë e Europës Lindore”. Qëllimi kryesor i tij është të promovojë zhvillimin e sektorit privat duke investuar në një gamë të gjerë sipërmarrjesh private. Fondi drejtohet nga menaxherë profesionistë të investimeve të cilët udhëhiqen nga Bordi i Drejtorëve të emëruar drejtpërsëdrejti nga Presidenti i SH.B.A.

Në 10 vjetorin e
SIGAL UNIQA
Kosova
inauguruam zyrat
e reja qendrore në
Prishtinë.



10 vjet SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Kosova

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Kosova festoi 10-vjetorin e aktivitetit përmes organizimit të mbrëmjes gala '10 vjet, 10 histori suksesi' gjatë të cilit SIGAL UNIQA Kosova vlerësoi 10 personalitete kosovare të fushave të ndryshme. Publiku kosovar propozoi emrat e preferuar në shkencë, sport, letërsi, muzikë, humanitet-sociale, kinematografi, ekonomi, art skenik.

Përgjatë këtyre 10 viteve, SIGAL UNIQA Kosova ka shënuar shumë arritje falë të cilave ka pasur një zhvillim të qëndrueshëm duke ruajtur standardet dhe parametrat e saj. Pak pas fillimit të aktivitetit SIGAL Kosova arriti një pozicion të mirë në treg dhe përgjatë



Mbrëmja artistike '10 vjet SIGAL UNIQA Kosova, 10 histori suksesi'.

gjithë periudhës ka zotëruar mesatarisht 15% të tregut pavarësisht rritjes së numrit të kompanive që operojnë në të. Tre vjet më parë grupi SIGAL UNIQA Group AUSTRIA investoi sërish në Kosovë duke krijuar SIGAL Life UNIQA Group AUSTRIA (Jetë). Falë këtij investimi dhe kujdesit të aksionerëve u mundësua plotësimi i të gjithë gamës së sigurimeve edhe në Kosovë duke iu ofruar klientëve produkte bashkëkohore në të gjitha klasat e jetës dhe jo-jetës.

Inaugurohen zyrat e reja qendrore në Prishtinë

Në përvjetorin e saj të 10-të, SIGAL UNIQA Kosova inauguroi zyrat e reja të Drejtorisë Qendrore të cilat tashmë janë një aset i kompanisë falë një investimi prej 2.5 milion Euro. Me një sipërfaqje prej rreth 1000 m², Drejtoria e re Qendrore është e pozicionuar në një prej zonave më të njohura të Prishtinës, në qytezën Pejton ku punojnë 60 punonjës të marrjes në sigurim, trajtimit të dëmeve dhe menaxhimit.

Investimi në pasuri të paluajtshme është pjesë e strategjisë së biznesit të SIGAL UNIQA dhe në sajë të tyre vlera e aseteve që kompania ka nën menaxhim ka arritur në rreth 26 Milionë Euro.



(Nga e majta në të djathtë): Z. Avni Ponari, CEO i SIGAL UNIQA, Z. Andreas Brandstetter, CEO UNIQA Insurance Group, Z. Wolfgang Kindl, CEO UNIQA International, Z. Martin Mata, Fondi Amerikan në ceremoninë e inaugurimit.

UNIQA Shkup rritje të qëndrueshme gjatë 2013

UNIQA Shkup operon në Maqedoni që prej vitit 2004 dhe ka pozicion të konsoliduar në tregun maqedonas të sigurimeve në të cilin operojnë 11 kompani sigurimi jo-jetë dhe 5 kompani sigurimi jetë. Duke iu referuar të dhënave zyrtare të Agjencisë Maqedonase të Mbikqyrjes së Sigurimeve, UNIQA Shkup ka pasur një rritje pozitive prej rreth 30% në krahasim me një vit më parë. Që prej 2011-ës, SIGAL UNIQA zgjeroi aktivitetin e saj në Maqedoni përmes themelimit të

UNIQA Life a.d për ofrimin e sigurimeve të jetës ritmet e zhvillimit të së cilës janë mbresëlënëse. UNIQA Shkup ka investuar gjithashtu në zgjerimin e rrjetit të saj të shitjes duke ofruar suksesshëm produkte sigurimi të klasave të jetës dhe jo-jetës. Nisur nga performanca pozitive e dy kompanive të grupit SIGAL UNIQA në Maqedoni dhe potenciali i madh që paraqet ky treg, Bordi i SIGAL UNIQA ka plane ambicioze për investime të mëtejshme.

Të gjitha shërbimet e SIGAL UNIQA ofrohen në një godinë të vetme

Një prej godinave më të njohura në Tiranë dhe në mbarë Shqipërinë, qendra Veve, tashmë është shndërruar në Qendra e Biznesit SIGAL. Kjo ndërtesë ekziston që prej më shumë se 50 vjetësh në Tiranë dhe si e tillë është mjaft e njohur dhe e reklamuar.

Pas finalizimit të procedurave dhe transaksioneve, e gjithë godina ka marrë emrin e Kompanisë duke e bërë SIGAL UNIQA-n një ndër të paktat kompani që kanë një ndërtesë me emrin e tyre.

Falë investimit të bërë, të gjithë klientët mund të marrin shërbimet dhe asistencën që u nevojitet në një godinë të vetme duke filluar nga blerja e policave për të gjitha produktet (jetë, shëndet, pasuri, makinë, pension privat) deri tek trajtimi i dëmeve (makinë, shëndet, pasuri, jetë) duke e shndërruar në këtë mënyrë godinën në një qendër biznesi të tipit 'one-stop-shop'. Krahas shërbimit të sigurimeve, Qendra ofron edhe ekzaminime dhe trajtime fizioterapie përmes Klubit të Shëndetit SIGAL UNIQA të pozicionuar në katin e parë të godinës.



Godina SIGAL Business Center ku ndodhet Drejtoria e Përgjithshme e grupit SIGAL UNIQA.

Takime dhe analiza financiare

Si çdo vit, edhe në 2013-ën stafi i SIGAL UNIQA u mbledh në një seri takimesh në kuadër të analizimit periodik të të dhënave financiare dhe performancës së grupit në të gjitha tregjet ku operon.

Takimi për të dhënat e 9-mujorit u zhvillua këtë vit në Prishtinë ku morën pjesë anëtarë të Bordit Mbikëqyrës të grupit SIGAL UNIQA dhe stafi drejtues i të gjitha kompanive. Në tremujorin e tretë të 2013 rritja e volumit të primeve në nivel grupi ishte 12.09% e cila i referohet totalit prej 32.3 Milionë Euro prime të shkruara. Vlen për tu theksuar se në këtë rritje ka luajtur një rol të rëndësishëm



Stafi Drejtues i grupit SIGAL UNIQA (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni) gjatë takimit rajonal 2013.

sigurimet vullnetare veçanërisht sigurimet e jetës, shëndetit dhe pensionet private si dëshmi e efektivitetit të strategjisë së Kompanisë për të rritur ndërgjegjësimin publik për këto sigurime.

Vazhdojmë suksesshëm
aktivitetin në Maqedoni
përmes dy kompanive:
UNIQA Jo-Jetë dhe
UNIQA Life



PËRGJEGJËSIA SOCIALE



Projekte mjedisore

Një ndër iniciativat mjedisore më të përhapura gjatë 2013-ës ishte nisma 'Ta pastrojmë Shqipërinë në një ditë' e cila u mbështet gjithashtu nga dhjetra punonjës të SIGAL UNIQA në Tiranë, Shkodër dhe Durrës më 22 Nëntor 2013. Nisma përfshiu për të dytin vit radhazi qindra njerëz nga çdo qytet i vendit duke synuar të kthehet në traditë përsa i përket kujdesit për një mjedis më të pastër. Gjithashtu, SIGAL UNIQA jep kontributin e saj për riciklimin e mbetjeve teknologjike në bashkëpunim me Recycle Albania.

Aktivitete sportive

Streetball Albania, një projekt sportiv i cili sjell basketbollin për të gjithë në fusha të hapura në rrugë, vijoi suksesshëm edhe gjatë vitit 2013 i mbështetur nga SIGAL UNIQA, Federata Shqiptare e Basketbollit dhe Bashkitë e qyteve ku u zhvillua aktiviteti. Dhjetëra të rinj kanë luajtur të organizuar në 40 skuadra si pjesë e këtij projekti i cili është gjerësisht i përhapur në botë. Paralelisht me këtë, në 2013 SIGAL UNIQA mbështeti edhe zhanre të tjera sportive ndër të cilat volejboli (Klubi Sportiv Vlora).

Artistët e rinj

I hapur që prej 4 vjetësh, Klubi i Artit dhe Kulturës i SIGAL UNIQA është në funksion të artistëve shqiptarë nga të gjitha trevat dhe vendi ideal për zbulimin dhe lancimin e talenteve të reja në art dhe kulturë. Ndër aktivitetet e tij të shumta, Klubi ka mirëpritur dhe

promovuar pa pagesë piktorë dhe instrumentistë të shumë shkollave 9-vjeçare, shkollave profesionale artistike si dhe studentë të Universitetit të Arteve. Krahas kësaj, gjatë vitit 2013 SIGAL UNIQA ka mbështetur konkurse në zbulim të talenteve të reja si Tirana Talent Show dhe Festivalin e Kitarës.

Trashëgimi kulturore

Që prej disa vjetësh jemi partnerë të organizatave dhe institucioneve të ndryshme me fokus tek ruajtja e trashëgimisë kulturore shqiptare dhe promovimit të saj në nivel ndërkombëtar. Në këtë kuadër, kemi mbështetur me kënaqësi aktivitete në kuadër të Ditëve të Trashëgimisë Kulturore Europiane të zhvilluara në disa qytete të vendit. Një tjetër projekt i rëndësishëm ishte edhe studimi dhe publikimi voluminoz mbi arkitekturën tradicionale shqiptare, i mbështetur gjithashtu nga SIGAL UNIQA.

Edukimi dhe punësimi

Ne besojmë thellësisht tek brezi i ri, idetë dhe energjia e tyre. Me këtë bindje mbështesim projekte të universiteteve në çdo qytet të Shqipërisë të cilat synojnë fuqizimin e të rinjve përmes prezantimit me tregun e punës si panairët e punësimit dhe programet e internshipit. Në vijimësi, politikat e punësimit janë në funksion të ngritjes profesionale nga niveli bazë i shitjes deri në nivelin më të lartë të menaxhimit bazuar tek performanca dhe synimet e gjithsecilit.

SIGAL

SIGAL 
UNIGA GROUP AUSTRIA




SIGAL

Mbi 100 mijë
klientë të rinj
na kanë besuar
sigurimin e
shëndetit, jetës dhe
aseteve të tyre.

NE JEMI SIGAL UNIQA



CEO i UNIQA Insurance Group Andreas Brandstetter gjatë analizës financiare të grupit SIGAL UNIQA.



Ekipet e futbollit SIGAL UNIQA (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni) gjatë përgatitjes për kampionatin UNIQA Football Championship.

Shifra dhe fakte

Gjatë vitit 2013, 1162 punonjës dhe agjentë kanë ofruar shërbimin e tyre profesional për klientët e SIGAL UNIQA në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni. 2013-a ishte viti gjatë të cilit 423 punonjës dhe agjentë iu shtuan skuadrës SIGAL UNIQA duke kaluar me sukses etapat e përzgjedhjes së kujdesshme.

Shifrat tregojnë për respektimin dhe aplikimin efektiv të politikave për barazinë gjinore në kompani ku 52% e punonjësve janë meshkuj dhe 48% janë femra.

Rreth 67% e stafit janë pjesë e grupit prej më shumë se 5 vjetësh duke dëshmuar në këtë mënyrë suksesin e politikave të burimeve njerëzore që ndjekim nën shembullin e aksionerit tonë më të madh UNIQA Insurance Group që ka 22,000 punonjës.

Përmirësimi i aftësive profesionale

Programi i vitit 2013 i trajnimeve profesionale të SIGAL UNIQA numëroi rreth 240 orë trajnime rutinë në vit në zyrat qendrore të kompanive në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni. Krahas këtyre, qindra punonjës trajnohen në një nivel më të avancuar çdo vit nga partnerët tanë në Austri dhe vende të tjera evropiane.

Në mbështetje të programeve të rritjes profesionale, SIGAL UNIQA ka mbështetur financiarisht përfshirjen në programe specializimi pasuniversitar të 16 punonjësve në universitetet shtetërore.

Vlerësimi dhe motivimi

Strategjia e SIGAL UNIQA për motivimin e punonjësve është hartuar në mënyrë të kujdesshme në bashkëpunim me ekspertë të fushës së menaxhimit të burimeve njerëzore. Vlerësimi periodik i performancës së punonjësve të çdo niveli duke filluar nga shitja deri tek menaxhimi i lartë, përbën bazën kryesore të praktikave të personalizuar të motivimit.

Shëndeti dhe mirëqenia fizike

Klubi i Shëndetit SIGAL VitalClub i cili ndodhet tashmë në qendër të Tiranës, ofron një sërë shërbimesh fizioterapie dhe fitnes falas për punonjësit e kompanisë. Duke marrë rregullisht këshilla për një dietë sa më të ekuilibruar dhe aktivitete sportive, ndihmojmë stafin që të fitojnë 'zakone të mira' për një stil të shëndetshëm jetese. Në mbështetje të kësaj janë krijuar edhe skuadra voleybolli dhe futbollit në të cilat rreth 30 punonjës stërviten çdo javë.

SHËRBIME LEHTËSUESE PËR KLIENTËT

Klubi i Shëndetit i SIGAL UNIQA tashmë mundëson edhe trajtime fizioterapie

Klubi i parë dhe i vetëm i shëndetit në Shqipëri, SIGAL UNIQA Vital Club ka shtuar shërbimet duke ofruar tashmë edhe trajtime profesionale fizioterapie. Që prej disa muajsh Klubi është pozicionuar në qendër të Tiranës dhe ka një staf fizioterapistësh profesionistë të cilët krahas ekzaminimeve të gjendjes fitnes ofrojnë trajtime për patologji të ndryshme si problemet neurologjike, reumatologjike, muskulo-faciale dhe dëmtimet sportive.

Problemet neurologjike vijnë nga dëmtimi i Sistemit Nervor. Këto probleme kanë shfaqje në forma të ndryshme duke përfshirë dhimbje, kufizime lëvizjeje dhe paraliza të një apo më shumë gjymtyrëve. Shkaqet e këtyre problemeve neurologjike mund të jenë aksidentet apo traumat e ndryshme, puna e rëndë fizike, pakujdesia në ambientet e punës, stili i jetesës ose shkaqe të tjera me natyrë gjenetike. Këtu përfshihen patologji si Hernia Disciale, Lumbalgjitë, Lumbago, Hemiparetikët, Hemiplegjikët, Paralizat Faciale, Pleksuset brakiale dhe dëmtimet aksidentale të medullës spinale.

Problemet Rheumatologjike përfshijnë një gamë të gjerë afeksionesh që kanë të përbashkët dhembjen dhe fluksionin (vërshimin e gjakut) të lokalizuar kryesisht në nivelin e artikulacioneve dhe prek muskujt, tendinet, ligamentet dhe të gjitha indet e buta që e rrethojnë atë. Ndër to përfshihen: Spondiloartrozat (qafës dhe mesit), Artritët e kyceve, Artrozat, Kifozat, Skoliozat dhe Osteoporoza.

Rehabilitimi Post-Traumatik dhe Post Operator përfshin frakturat e kockave dhe traumat aksidentale.

Problemet muskulo-faciale shpesh vijnë si pasojë e



Klubi i Shëndetit SIGAL VitalClub tashmë ndodhet në qendër të Tiranës.

një sforcimi fizik ose një pozicioni jokorrekt të trupit dhe përfshijnë: Kontrakturat muskulare, Tërheqjet muskulare, Distonitë muskulare, Hipotrofitë muskulare.

Dëmtimet sportive dhe problemet muskulare tek sportistët të cilat përfshijnë tendinitet, ligamentet, distorsionet, luksacionet.

Për të gjithë klientët e SIGAL UNIQA, Klubi i Shëndetit ofron paketa preferenciale përfshirë një set seancash fizioterapeutike pa pagesë.

Në një hap më teknologjinë, lancimi i 'E-Assitance'



Përmes lancimit të faqes së re zyrtare të Kompanisë është zgjeruar fusha e shërbimeve dhe informacioneve që klientët mund ti aksesojnë online.

Ndjekje online i procedimit të faturave mjekësore

Përmes kësaj rubrike të gjithë klientët e SIGAL UNIQA të pajisur me një kartë shëndetësore, mund të ndjekin online fazën në të cilin ndodhet kërkesa e tyre për rimbursim. Duke futur të dhënat personale, çdo klient mund të shohë detajet e kërkesës për rimbursim dhe konfirmimin e rimbursimit.

Llogaritje e menjëhershme e pensionit privat

Klientët dhe personat e interesuar për një pension privat shtesë tek Fondi i Pensioneve Private SIGAL Life, kanë mundësi të llogarisin pensionin e tyre brenda pak minutash përmes faqes së internetit.

Duke plotësuar fushat e kërkuara (moshën, kohëzgjatjen e kontratës, kontributin mujor etj),

sistemi gjeneron automatikisht shumën totale të paguar përgjate viteve, shumën e akumuluar në momentin e tërheqjen së pensionit si dhe pensionin mujor.

Njoftim online i dëmit

Për të gjithë klientët e SIGAL UNIQA që kanë siguruar shëndetin, shtëpinë apo makinën e tyre dhe kanë pësuar një dëm shëndetësor apo material mund ta raportojnë atë përmes hapësirës 'Raporto dëmin online'. Brenda një kohe shumë të shkurtër nga marrja e njoftimit përmes formularit të plotësuar të dëmit ekspertët tanë të trajtimit të dëmëve kontaktojnë klientët për t'u ofruar asistencën e nevojshme.

Aplikacione për android dhe smartphone


Një ndër planet ambicioze të Departamentit të Teknologjisë Informative të SIGAL UNIQA është lancimi i aplikacioneve në dobi të klientëve të cilët preferojnë celularin për kryerjen e veprimeve për blerjen e policave të sigurimit që preferojnë.



Klubi i shëndetit
SIGAL
VITALCLUB
tashmë në qendër
të Tiranës.

TË DHËNA FINANCIARE

Grupi SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA
Prime të shkruara për tre vitet e fundit




Kompania	2011 (në Euro)	2012 (në Euro)	2013 (në Euro)
SIGAL UNIQA AL Jo-Jetë dhe Risigurime	17,133,284	17,598,129	18,920,508
SIGAL Life UNIQA AL	3,645,281	3,228,050	4,136,826
SIGAL Life UNIQA SH.A.F.P*	576,615	961,625	1,442,152
SIGAL UNIQA KS Jo-Jetë	8,368,689	9,222,743	10,912,741
SIGAL Life UNIQA KS*	5,000	188,126	238,858
UNIQA MK Jo-Jetë	7,538,356	8,041,964	10,371,295
UNIQA Life MK*	218,173	672,530	669,719
GRUPI	37,485,397	39,913,167	46,692,100

* SIGAL Life UNIQA SH.A.F.P ka filluar veprimtarinë më 30 Mars 2011. Të dhënat për Fondin janë progresive.

* SIGAL Life UNIQA KS ka filluar veprimtarinë më Shtator 2011.

* UNIQA Life MK ka filluar veprimtarinë më Maj 2011.

Prime të shkruara sipas produkteve për vitin 2013



Lloji i Produktit	AL (në Euro)	KS (në Euro)	MK (në Euro)	Grupi (në Euro)
Pasuri	9,062,649	1,675,648	2,385,697	13,123,994
M. Motorike	7,251,617	7,340,872	7,196,596	21,789,086
Jetë, Shëndet dhe Aksidente	6,359,457	2,135,080	1,458,721	9,953,258
Pensione Vullnetare*	1,442,152	-	-	1,442,152
Risigurime*	383,611	-	-	383,611
TOTALI	24,499,486	11,151,600	11,041,014	46,692,100


* Produktet e Pensioneve vullnetare dhe Risigurimet ofrohen vetëm në Shqipëri përkatësisht nga kompanitë SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Risigurime dhe SIGAL Life UNIQA SH.A.F.P.

ZHVILLIMET NË TREGUN RAJONAL TË SIGURIMEVE

Tregu shqiptar i sigurimeve jo-jetë

Tregu i sigurimeve të jo-jetës, në të cilin operojnë 9 kompani, u udhëhoq nga SIGAL UNIQA e cila zotëroi 34.52% të tregut.


SIGAL UNIQA
34.52%



Tregu shqiptar i sigurimeve të jetës

Që prej disa vjetësh, në tregun shqiptar të sigurimeve të jetës operojnë 3 kompani sigurimi. Edhe për vitin 2013 tregu u udhëhoq nga SIGAL Life UNIQA me 60.41%.


SIGAL Life UNIQA
60.41%



Tregu shqiptar i pensioneve private


Gjatë vitit 2013, në tregun e pensioneve operuan 3 fonde pensionesh private. Fondi i Pensioneve SIGAL udhëhoqi tregun si për numrin e kontribuesve (44.41%) ashtu edhe për totalin e kontributeve të derdhura.

Fondi i Pensioneve SIGAL
44.41%




Tregu kosovar i sigurimeve

Në tregun kosovar operojnë 10 kompani sigurimi ndër të cilat SIGAL UNIQA Kosova renditet e dyta me 14.1% të tregut për volumin e primeve.




Në tregun kosovar të sigurimeve të jetës operojnë 3 kompani ndër të cilat SIGAL Life UNIQA Kosova renditet e treta me 11.6% të tregut për volumin e primeve.




Tregu maqedonas i sigurimeve

Në tregun maqedonas të sigurimeve të jo-jetës operojnë 12 kompani. UNIQA a.d. u rendit në vendin e gjashtë për nga volumi i primeve të shkruara (9.8%).



UNIQA Life renditet e treta në tregun maqedonas të sigurimeve të jetës (6%) në të cilin operojnë 5 kompani.



SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a.
Pasqyrat Financiare të Konsoliduara
për vitin e mbyllur më
31 Dhjetor 2013
(me raportin e audituesit bashkëlidhur)

*Consolidated Financial Statements
as at 31 December 2013
(with the independent auditor's report thereon)*

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Aksionarëve dhe Bordit Drejtues të SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Sh.a.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara të SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Sh.a. dhe filialeve të saj ("Grupit"), të cilat përbëhen nga pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2013 dhe pasqyra e konsoliduar e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapital dhe pasqyra e konsoliduar e fluksit të parasë për vitin ushtrimor të mbyllur në këtë datë si dhe nga një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe informacio tjetër shpjegues.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon si të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara që nuk përmbajnë anomali materiale qofshin ato për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Përgjegjësia e Audituesit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra të konsoliduara financiare bazuar në auditimin tonë. Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të arritur sigurinë e arsyeshme për faktin nëse pasqyrat financiare të konsoliduara janë pa anomali materiale.

Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencën e auditimit rreth shumave dhe shënimeve shpjeguese të dhëna në pasqyrat financiare të konsoliduara. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rrezikut të anomalive materiale të pasqyrave financiare të konsoliduara qofshin këto për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë kryerjes së këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që ka të bëjë me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të konsoliduara, me qëllim që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për të shprehur një opinion për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të njësisë ekonomike. Një auditim përfshin gjithashtu, vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të kryera nga drejtimi, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare të konsoliduara.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.


Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të konsoliduara japin një paraqitje të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, të pozicionit financiar të grupit më 31 dhjetor 2013, si dhe të performancës së saj financiare dhe te flukseve të parasë për vitin ushtrimor e mbyllur më këtë datë, në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të konsoliduar të Grupit për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2012 janë audituar nga një shoqëri tjetër audituese, raporti i të cilës, më datë 28 Maj 2013, përmbante një opinion të pamodifikuar për ato pasqyra financiare.


PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k.
20 Qershor 2014
Tiranë, Shqipëri


Statutory auditor
Kledian Kodra, FCCA

INDEPENDENT AUDITOR'S REPORT

To the Shareholder's and Board of Directors of SIGAL UNIQA Group Austria sh.a.

We have audited the accompanying consolidated financial statements of SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a. and its subsidiaries (the "Group"), which comprise the consolidated statement of financial position as at 31 December 2013 and the consolidated statements of profit or loss and other comprehensive income, changes in equity and cash flows for the year then ended, and notes comprising a summary of significant accounting policies and other explanatory information.

Management's Responsibility for the Consolidated Financial Statements

Management is responsible for the preparation and fair presentation of these consolidated financial statements in accordance with International Financial Reporting Standards, and for such internal control as management determines is necessary to enable the preparation of financial statements that are free from material misstatement, whether due to fraud or error.

Auditor's Responsibility

Our responsibility is to express an opinion on these consolidated financial statements based on our audit. We conducted our audit in accordance with International Standards on Auditing. Those standards require that we comply with ethical requirements and plan and perform the audit to obtain reasonable assurance about whether the consolidated financial statements are free from material misstatement.

An audit involves performing procedures to obtain audit evidence about the amounts and disclosures in the consolidated financial statements. The procedures selected depend on the auditor's judgment, including the assessment of the risks of material misstatement of the consolidated financial statements, whether due to fraud or error. In making those risk assessments, the auditor considers internal control relevant to the entity's preparation and fair presentation of the consolidated financial statements in order to design audit procedures that are appropriate in the circumstances, but not for the purpose of expressing an opinion on the effectiveness of the entity's internal control. An audit also includes evaluating the appropriateness of accounting policies used and the reasonableness of accounting estimates made by management, as well as evaluating the overall presentation of the consolidated financial statements.

We believe that the audit evidence we have obtained is sufficient and appropriate to provide a basis for our audit opinion.

Opinion

In our opinion, the consolidated financial statements present fairly, in all material respects, the financial position of the Group as at 31 December 2013, and its financial performance and its cash flows for the year then ended in accordance with International Financial Reporting Standards.

Other Matter

The consolidated financial statements of the Group for the year ended 31 December 2012 were audited by another firm of auditors whose report, dated 28 May 2013, expressed an unmodified opinion on those statements. Our opinion is not qualified in respect of this matter.



PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k.

20 June 2014

Tirana, Albania



Statutory auditor

Kledian Kodra, FCCA

Pasqyra e Konsoliduar e Pozicionit Financiar

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

	Shënime	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012 Rideklaruar
AKTIVET:			
Mjete monetare dhe ekuivalentë	10	427,494	351,494
Depozita me afat me bankat	11	5,369,719	5,100,853
Investime në filiale	12	946,700	718,701
Llogari të arkëtueshme nga sigurimi dhe të tjera	13	922,618	969,017
Aktive të risigurimit	14	697,074	240,604
Kostot e shtyra të marrjes në sigurim	15	505,726	458,309
Inventari		5,357	14,224
Tatim fitimi i arkëtueshëm		12,538	27,689
Ndërtesa dhe pajisje	16	1,279,298	1,160,882
Aktive të tjera	17	204,332	231,644
TOTALI I AKTIVEVE		10,370,856	9,273,417
DETYRIMET			
Detyrime për humbjet dhe axhustimet e humbjeve	18	2,844,862	2,493,379
Rezerva për primet e pafituara	18	3,025,198	2,527,643
Rezerva të tjera	18	402,898	250,517
Detyrime nga sigurimet dhe risigurimet	19	257,804	193,657
Detyrime të tjera	20	177,341	199,507
TOTALI I DETYRIMEVE		6,708,103	5,664,703
KAPITALI			
Aksione të zakonshme	21	2,232,909	2,232,909
Rezerva të tjera të kapitalit		52,133	52,133
Rezerva e riskut të sigurimit	22	466,519	389,238
Rezerva e konvertimit të monedhave të huaja		112,782	101,148
Fitime të akumuluar		789,388	821,831
Totali i kapitalit ndaj aksionareve të shoqërisë mëmë		3,653,731	3,597,259
Interesat e pakicës		9,022	11,455
TOTALI I KAPITALIT		3,662,753	3,608,714
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		10,370,856	9,273,387

Këto pasqyra financiare të konsoliduara janë aprovuar nga Drejtuesit e Shoqërisë më 30 Maj 2014 dhe janë nënshkruar nga:

Avni Dëllari
Drejtues i përgjithshëm

Klement Mersini
Shef i financës

Consolidated Statement of Financial Position

as at 31 december 2013

(All amounts are expressed in thousand Lek, unless otherwise stated)

	Note	31 December 2013	31 December 2012 Restated
ASSETS			
Cash and cash equivalents	10	427,494	351,494
Term deposits	11	5,369,719	5,100,853
Investments in securities	12	946,700	718,701
Insurance and other receivables	13	922,618	969,017
Reinsurance assets	14	697,074	240,604
Deferred acquisition costs	15	505,726	458,309
Inventory		5,357	14,224
Corporate income tax receivable		12,538	27,689
Property and equipment	16	1,279,298	1,160,882
Other assets	17	204,332	231,644
TOTAL ASSETS		10,370,856	9,273,417
LIABILITIES			
Liabilities for losses and loss adjustment expenses	18	2,844,862	2,493,379
Unearned premium reserve	18	3,025,198	2,527,643
Other reserves	18	402,898	250,517
Insurance and reinsurance payables	19	257,804	193,657
Other payables	20	177,341	199,507
TOTAL LIABILITIES		6,708,103	5,664,703
EQUITY			
Ordinary shares	21	2,232,909	2,232,909
Other capital reserves		52,133	52,133
Insurance risk reserves	22	466,519	389,238
Translation reserves		112,782	101,148
Retained earnings		789,388	821,831
Total equity attributable to owners of the Parent		3,653,731	3,597,259
Non-controlling interest		9,022	11,455
TOTAL EQUITY		3,662,753	3,608,714
TOTAL EQUITY AND LIABILITIES		10,370,856	9,273,387

These consolidated financial statements have been approved by the Directors of the Group on 30 May 2014 and signed on their behalf by:


Avni Romari
General Manager


Klement Mersini
Finance Manager

Pasqyra e Konsoliduar fitim/humbje dhe të tjera e të Ardhurave Përmbledhëse

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

	Note	2013	2012
Prime të shkruara bruto	23	6,230,614	5,318,512
Prime të ceduar risiguruesve	24	(1,082,082)	(529,770)
Të ardhura neto nga primi i sigurimit		5,148,532	4,788,742
Ndryshimi në rezervën për prime të papërfituara	18	(492,708)	(133,601)
Ndryshimi në rezervën për prime të ceduara risiguruesve	14	359,750	(15,157)
Të ardhura neto nga primet		5,015,574	4,639,984
Të ardhura nga investimet	25	213,722	189,316
Të ardhura të tjera	26	102,474	90,609
Të ardhura neto		5,331,770	4,919,909
Ndryshimi në rezerva të tjera	18	(152,381)	(122,646)
Ndryshimi në risigurime të mbledhshme	18	101,423	50,013
Dëme dhe shpenzime të axhustimit të humbjeve	18	(2,062,097)	(1,935,496)
Dëme të sigurimit neto		(2,113,055)	(2,008,129)
Kostot e marrjes në sigurim	27	(906,928)	(787,176)
Shpenzime administrative dhe marketingu	28	(1,420,919)	(1,307,129)
Shpenzime të tjera sigurimi	29	(636,879)	(531,148)
Humbje nga kurset e këmbimit		(27,932)	(8,120)
Fitimi para tatimit		226,057	278,207
Tatimi mbi fitimin	30	(41,219)	(24,482)
Fitimi i vitit		184,838	253,725
Të ardhura të tjera përmbledhëse		11,634	10,073
Totali i të ardhurave përmbledhëse të vitit		196,472	263,798
Fitimi i atribueshëm për:			
Pronarët e kompanisë mëmë		187,253	256,065
Interesat e pakicës		(2,415)	(2,340)
Totali i të ardhurave përmbledhëse të atribueshme për:			
Aksionarëve të shoqërisë mëmë		198,887	266,138
Interesat e pakicës		(2,415)	(2,340)

Consolidated Statement of profit or loss and other Comprehensive Income

for the year ended 31 december 2013

(All amounts are expressed in thousand Lek, unless otherwise stated)

	Note	2013	2012
Premium revenue	23	6,230,614	5,318,512
Premium ceded to reinsurers	24	(1,082,082)	(529,770)
Net written premium		5,148,532	4,788,742
Change in provision for unearned premium	18	(492,708)	(133,601)
Change in provision for unearned premium ceded to reinsurers	14	359,750	(15,157)
Net earned premium		5,015,574	4,639,984
Investment income	25	213,722	189,316
Other income	26	102,474	90,609
Net Income		5,331,770	4,919,909
Change in other reserve	18	(152,381)	(122,646)
Change in reinsurance recoverable	18	101,423	50,013
Insurance claims and loss adjustment expenses	18	(2,062,097)	(1,935,496)
Net Insurance claims		(2,113,055)	(2,008,129)
Acquisition costs	27	(906,928)	(787,176)
Administration and marketing expenses	28	(1,420,919)	(1,307,129)
Other insurance expenses	29	(636,879)	(531,148)
Foreign exchange losses		(27,932)	(8,120)
Profit before income tax		226,057	278,207
Income tax expense	30	(41,219)	(24,482)
Profit for the year		184,838	253,725
Other comprehensive income		11,634	10,073
Total comprehensive Income for the year		196,472	263,798
Profit attributable to:			
Owners of the parent		187,253	256,065
Non-controlling interest		(2,415)	(2,340)
Total comprehensive Income attributable to:			
Owners of the parent		198,887	266,138
Non-controlling Interest		(2,415)	(2,340)

Pasqyra e Konsoliduar e Lëvizjeve në Kapital

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

	Kapitali themeltar	Rezerva të tjera të kapitalit	Rezerva të riskut të sigurimit
Gjendja më 1 janar 2012	2,232,909	52,133	324,840
Fitimi / (Humbja) për vitin	-	-	-
Të ardhura të tjera përmbledhëse neto	-	-	-
Total i të ardhurave përmbledhëse të vitit	-	-	-
Ndarja e fitimeve të mbartura	-	-	64,398
Blerja e filialit me interesa të pakicës			
Interesat e pakicës në datën e blerjes	-	-	-
Totali i kontributeve dhe shpërndarja tek pronarët	-	-	64,398
